



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 163/2014

**PËR URDHRIN E PUNONJËSVE SOCIALË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është rregullimi i organizimit dhe veprimtarisë së Urdhrit të Punonjësve Socialë, si dhe i marrëdhënieve juridike dhe etiko-profesionale të punonjësve socialë.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e profesionit të punonjësit social, garantimi i standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të punonjësit social.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë punonjësit socialë që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik dhe atë privat.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punë sociale” është veprimtaria profesionale e bazuar te praktika, si dhe një disiplinë akademike që promovon ndryshimin, zhvillimin, kohezionin social dhe drejtësinë sociale, si dhe fuqizimin dhe pavarësimin e njerëzve.

2. “Punonjës social” është një profesion i rregulluar që ushtrohet në fushën e punës sociale, në nivel makro, mezo dhe mikro, në shërbim të individëve, familjeve, grupeve, komuniteteve, institucioneve të nivelit qendror e vendor në sistemin publik dhe privat.

Neni 5

Statusi

Urdhri i Punonjësve Socialë është ent publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

KREU II

MISIONI DHE BUXHETI

Neni 6

Misioni

Misioni i Urdhrit është garantimi dhe ruajtja në vazhdimësi e standardeve dhe praktikave të mira të ushtrimit të profesionit në fushën e punës sociale dhe mbrojtja e publikut nga veprimet joprofesionale dhe joetike të punonjësve socialë.

Neni 7

Kompetencat e Urdhrit të Punonjësve Socialë

Për realizimin e misionit të tij, Urdhri i Punonjësve Socialë ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq të drejtën e ushtrimit individual të profesionit të punonjësit social nëpërmjet dhënies dhe revokimit të licencës profesionale;

b) krijon dhe përditëson regjistra të posaçëm, sipas fushës së veprimtarisë dhe profileve;

c) miraton standarde etike të detyrueshme për punonjësit socialë, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre në praktikën profesionale;

ç) mbron të drejtat e anëtarëve të urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre, si dhe pavarësinë e ushtrimit të profesionit;

d) nxit në vazhdimësi punonjësit socialë në përdorimin e standardeve më të larta dhe të praktikave më të mira në fushën e punës sociale;

dh) kontribuon, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, për sigurimin e standardeve më të larta dhe praktikave më të mira në edukimin dhe formimin etik, profesional dhe shkencor të punonjësit social;

e) kontribuon, në marrjen e masave të nevojshme e të përshtatshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mbrojtjes e mirëqenies sociale të popullatës;

ë) informon publikun përmes njoftimeve, buletineve periodike, botimeve shkencore dhe botimeve të tjera të veçanta, nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar;

f) kontribuon në zbatimin e programeve shtetërore, të enteve dhe organizatave të tjera publike e private, në funksion të interesit publik.

Neni 8

Anëtarësimi në Urdhër

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e punonjësit social, në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.

2. Janë anëtarë të Urdhrit të Punonjësve Socialë të gjithë punonjësit socialë që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e punonjësit social, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Kërkesa minimale për formimin dhe kualifikimet profesionale për punonjësit socialë është që të zotërojnë një diplomë në fushën e punës sociale brenda ose jashtë vendit. Për kategori të ndryshme të formimit dhe të kualifikimeve profesionale të punonjësve socialë, kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;

c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;

ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit, dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësve Social.

3. Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të punonjësit social në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të anëtarësohen paraprakisht në Urdhrin e Punonjësve Socialë të Republikës së Shqipërisë dhe të njohin të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë profesionin e punonjësit social. Punonjësi social, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (*Good Standing Certificate*) nga urdhri/dhoma apo shoqata e punonjësve socialë të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njohjen e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Punonjësve Sociale.

Për punonjësin social të huaj, i cili nuk njeh gjuhën shqipe, detyrimisht është kusht të punojë me përkthyes.

4. Anëtarët e Urdhrit kanë detyrim të paguajnë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifën e regjistrimit, të licencimit dhe për shërbime të tjera administrative.

5. Individëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, që, në momentin e hyrjes në fuqi të legjislacionit për profesionet e rregulluara për punonjësin social, kanë të dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional për ushtrimin e këtij profesioni, sipas shkronjës "b", të pikës 2, të këtij neni, u lind e drejta e menjëhershme e anëtarësimin në Urdhër.

Neni 9

Bashkëpunimi

1. Urdhri, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, arsimin, shëndetësinë, punët e brendshme, drejtësinë dhe institucionet e tyre të varësisë, institucionet e pavarura dhe organizma të tjerë, publikë ose privatë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Punonjësve Socialë informon çdo 6 muaj ministrinë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjykimit profesional.

3. Inspektoratet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë me Urdhrit gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministrinë e përmendura në pikën 1 të këtij neni bashkëpunojnë me Urdhrit për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve të rëndësishme në fushën e shërbimeve sociale dhe punës sociale.

Neni 10

Buxheti

1. Urdhri i Punonjësve Socialë ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky Këshill.

2. Burimet financiare të Urdhrit të Punonjësve Socialë janë të ardhurat nga:

a) kuotizacionet e anëtarëve, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe janë të detyrueshme për çdo anëtar;

b) tarifën e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Të ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.

KREU III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 11

Organet kryesore

1. Organet kryesore të Urdhrit të Punonjësve Socialë janë:

a) Asambleja e Urdhrit;

- b) Këshilli Kombëtar i Urdhrit;
 - c) Kryetari i Urdhrit;
 - ç) Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.
2. Organet kryesore të Urdhrit shtrihen edhe në nivelin e qarkut, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e Urdhrit.

Neni 12

Asambleja e Urdhrit

1. Asambleja e Urdhrit është organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrës i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.
2. Mbledhja e asamblesë thirret nga:
 - a) Kryetari i Këshillit Kombëtar;
 - b) kur kërkohet nga 1/5 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.
3. Procedurat e vendimmarrjes dhe funksionimit të Asamblesë së Urdhrit rregullohen në statutin e Urdhrit.

Neni 13

Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 15 anëtarë, ndër të cilët 9 janë të zgjedhur nga Asambleja dhe 6 të tjerët janë përkatësisht Kryetari i Urdhrit, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, një përfaqësues me rotacion nga ministritë e përmendura në pikën 1, të nenit 9, të këtij ligji, një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë të shkencave të punës sociale, një përfaqësues nga shoqatat e punonjësve socialë, të caktuar nga Kryetari i Urdhrit, sipas kriterëve të përcaktuara në statut.
2. Këshilli Kombëtar ka këto kompetenca:
 - a) miraton strukturën e vet organizative;
 - b) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit;
 - c) miraton statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe Kodin Etik Deontologjik të Punonjësit Social;
 - ç) zgjedh Kryetarin e Urdhrit dhe zëvendësin e tij;
 - d) mban dhe përditëson Regjistrin e Punonjësve Socialë të Urdhrit;
 - dh) mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Urdhrit që varen prej tij;
 - e) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontroleve për ushtrimin e profesionit të punonjësit social.
3. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 3 vjet.

Neni 14

Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë

1. Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë është kryetari i Këshillit Kombëtar dhe përfaqëson Urdhrin në marrëdhëniet me palët e treta.
2. Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja, midis jo më pak se dy kandidaturave alternative.

3. Mandati i Kryetarit të Urdhrit është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
4. Kandidaturat për Kryetar të Urdhrit të Punonjësve Socialë duhet të përmbushin këto kritere:
- a) të jenë shtetas shqiptarë, rezidentë në Shqipëri;
 - b) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
 - c) të kenë jo më pak se pesë vjet përvojë në profesion, nga të cilat të paktën një vit ta kenë ushtruar gjatë pesë vjetëve të fundit;
 - ç) të kenë aftësi komunikuese, organizuese dhe drejtuese;
 - d) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
 - dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale.
5. Funkzioni i Kryetarit të Urdhrit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.
6. Mandati i Kryetarit të Urdhrit mbaron para kohe në këto raste:
- a) kur merret vendim nga Këshilli Kombëtar me votat e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve;
 - b) kur jep dorëheqjen;
 - c) kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - ç) kur humbet zotësinë e plotë për të vepruar;
 - d) kur bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrën, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Urdhrit të Punonjësve Socialë përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

Neni 15

Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjykimit profesional.
2. Komisioni verifikon dhe shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësit Social.
3. Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional përbëhet nga 7 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional përcaktohet në statut dhe në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit.

Neni 16

Masat disiplinore

1. Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor Profesional heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Profesionale ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) vërejtje me paralajmërim;
 - c) gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë;

ç) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Punonjësve Socialë deri në 3 vjet;

d) revokimin e licencës individuale profesionale dhe përjashtimin nga Urdhri për një periudhë deri në 3 vjet;

dh) propozim për shkarkim nga organet drejtuese.

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese të përcaktuara me rregullore.

3. Masat disiplinore, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b", dhe, brenda 3 vjetësh nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "ç" dhe "d", ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 17

Ankimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor Profesional paraqiten pranë këtij komisioni brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

2. Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor Profesional, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit Disiplinor Profesional është përfundimtar.

3. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit Disiplinor Profesional ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

Organizimi i zgjedhjeve të para

1. Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, detyra e të cilit është të organizojë zgjedhjet e para të urdhrit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar të Urdhrit, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Neni 19

Dispozita kalimtare për individët që ushtrojnë profesionin e punonjësit social dhe profesione të tjera të punës sociale

1. Individët që, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të caktuar kohe, por nuk kanë formimin dhe kualifikimin profesional minimal, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 8, të këtij ligji, mund të vazhdojnë ushtrimin e profesionit të

punonjësit social për një afat të caktuar, por janë të detyruar të ndjekin programe të formimit dhe kualifikimit/rikualifikimit profesional, të përshtatshme për ushtrimin e profesionit të tyre.

2. Procedurat, kriteret dhe afatet për ndjekjen e programeve të formimit dhe kualifikimit/rikualifikimit profesional, si dhe afatet brenda të cilave individët, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të vazhdojnë të ushtrojnë profesionin e punonjësit social, së bashku me të drejtat, detyrimet dhe kushtëzimet e mundshme që këta individë mund të kenë në marrëdhënie me administratën publike dhe private, ashtu si dhe me vetë Urdhrin, si pasojë e mangësive të tyre në formimin dhe kualifikimin profesional, si dhe periudha e eksperiencës së punës, e nevojshme për të lindur e drejta për vazhdimin e ushtrimit të profesionit, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe dokumentacioni i nevojshëm për vërtetimin e saj, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Individët, sipas pikës 1, të këtij neni, regjistrohen përkohësisht në një regjistër të posaçëm të Urdhrit deri në përmbushjen e kriterëve të nevojshme të anëtarësimit.

Neni 20

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjës “b”, pika 2, të nenit 8, dhe të pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 4.12.2014